



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1361 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 213, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit Hidroenergjitik të Devollit-"Rrugët rurale që lidhin fshatrat Peshtan dhe Pulaha (Kodras), Moglicë-Korçë"*-subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit Hidroenergjitik të Devollit-"Rrugët rurale që lidhin fshatrat Peshtan dhe Pulaha (Kodras), Moglicë-Korçë"*-subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k..
2. Subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projektit *"Rrugët rurale që lidhin fshatrat Peshtan dhe Pulaha (Kodras), Moglicë-Korçë"*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al